

VENDIM
Nr. 166, datë 4.11.2019

MBI MIRATIMIN E “RREGULLORES MBI SISTEMIN E NJËSUAR TË LLOGARIVE PËR SHOQËRITË E RREGULLUARA NË SEKTORIN E GAZIT NATYROR”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 16, pika 14, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, si dhe neneve 2 dhe 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 4.11.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e protokolluar me nr. 89/7 prot., datë 12.9.2019, si dhe relacionin shtesë, protokolluar me nr. 89/7-1 prot., datë 39.10.2019, përgatitur nga drejtoritë teknike, konstatoi se:

- Me vendimin nr. 76, datë 31.5.2019, Bordi i ERE-s ka vendosur fillimin e procedurës për miratimin e “Rregullores mbi sistemin e njësuar të llogarive për shoqëritë e licencuara në sektorin e gazit natyror, përfshirë auditimin e llogarive”.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje, duke u mbështetur në përcaktimet e nenit 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, me shkresën nr. 32/28, datë 6.6.2019, vendimi i sipërcituar u publikua në median e shkruar, në mënyrë që palët e interesuara të shprehin opinionet dhe komentet e tyre, brenda 15 ditëve nga dita e publikimit.

- Me shkresën nr. 397 prot., datë 13.6.2019 dhe me shkresën nr. 397/2 prot., datë 9.7.2019, ERE bëri me dije shoqërinë “Albgaz” sh.a. mbi këtë vendimmarrje, si dhe kërkoi opinion prej saj brenda afateve të përcaktuara.

- “Albgaz” sh.a., me shkresën nr. 70 prot., datë 8.7.2019, u shpreh parimisht dakord për këtë drafttregullore dhe për përmbajtjen e saj duke e konsideruar të mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të cilat zbatohen prej shoqërisë.

- Me urdhër nr. 93, datë 19.7.2019, të kryetarit të ERE-s, u zhvillua një seancë dëgjimore lidhur me shqyrtimin e këtij drafti, ku me shkresën nr. 397/3 prot., datë 23.7.2019, u njoftuan të licencuarit në sektorin e gazit natyror, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe Autoriteti i Konkurrencës. Pjesëmarrës në këtë seancë ishin “Albgaz” sh.a. “Autoriteti i Konkurrencës” dhe “Anio Oil & Gaz” sh.a.

- “Albgaz” sh.a. u shpreh se ishte përshtatur standardi ndërkombëtar, por lista e llogarive ka nevojë për t’u rregulluar për shoqëritë aksionare dhe kjo do t’i mbetej së ardhmes.

- “Anio Oil & Gaz” sh.a. u shpreh se drafttregullorja ishte e qartë, specifike dhe sipas standarteve.

- Autoriteti i Konkurrencës u shpreh se drafttregullorja nuk binte në kundërshtim me ligjin nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

- Shoqëria “C.G.C” sh.p.k. nëpërmjet shkresës nr. 397/4 prot., datë 29.7.2019, protokolluar në ERE, në pamundësi për të qenë pjesëmarrëse në seancën dëgjimore e zhvilluar më datë 26.7.2019, ka kërkuar informacion për çështjet e trajtuara në këtë seancë.

- ERE me shkresën nr. 397/5 prot., datë 2.8.2019, referuar kërkesës së shoqërisë “C.G.C” sh.p.k., i ka vënë në dispozicion informacionin dhe vlerësimet që u bënë nga pjesëmarrësit e tjerë në seancë për këtë drafttregullore, si dhe i dha orientim se këtë drafttregullore mund ta aksesojë në faqen zyrtare të ERE-s: www.ere.gov.al në seksionin publikime-konsultime.

- Në përfundim të këtij procesi, ERE ka ftuar palët, të shprehen zyrtarisht mbi sugjerimet e tyre. Pas kësaj ftese, nuk rezulton që në ERE të jenë paraqitur qëndrimet e kërkuara.

- Gjatë procedurës për miratimin e kësaj rregullore, ERE konkludoi se shoqëritë kanë detyrim të paraqesin pranë ERE-s pasqyrat financiare të auditura sipas legjislacionit në fuqi për auditimin, duke qartësuar se auditimi nuk kryhet nga ERE. Kjo sjell ndryshimin e rregullores për këtë pjesë, duke ndërhyrë në titull dhe në përmbajtje.

- Gjatë procedurës për miratimin e kësaj rregullore, u konkludua se zbatimi i saj është i detyrueshëm jo vetëm për shoqëritë e licencuara nga ERE, por për të gjitha shoqëritë, veprimtaria e të cilave është objekt rregullimi nga ana e ERE. Kjo reflektohet në përmbajtjen e rregullores.

- ERE ka autoritetin për miratimin e rregullores mbi sistemin e njësuar të llogarive në sektorin e gazit natyror mbështetur në:

- nenin 30 të ligjit “Për sektorin e gazit natyror”, ku përshkruhet në detaje metoda e mbajtjes së llogarive dhe përgatitjes së pasqyrave financiare të shoqërive të rregulluara;

- nenin 31 të ligjit “Për sektorin e gazit natyror”, ku përcaktohet se ERE, në kryerjen e funksioneve të saj, ka të drejtën e aksesit në të dhënat dhe dokumentacionin financiar të shoqërive të gazit natyror, sipas përcaktimeve të nenit 30 të këtij ligji.

- Në zbatim të këtij detyrimi ligjor, ERE në konsulencë me USAID-in, ka përgatitur draftrregulloren mbi sistemin e njësuar të llogarive për shoqëritë e rregulluara në sektorin e gazit natyror.

- Rregullorja, paraqitet e strukturuar në 16 nene dhe një shtojcë e cila përmban listën e llogarive të ndara sipas aktiviteteve të licencuara dhe do të shërbejë si udhëzues i mbajtjes së llogarive nga të licencuarit në sektorin e gazit natyror me qëllim ushtrimin nga ERE të detyrës së kontrollit dhe monitorimit të llogarive të shoqërive që ushtrojnë aktivitetin në sektorin e gazit natyror.

- Shtojca 1 e rregullores, është hartuar duke bërë një ndarje të llogarive sipas veprimtarive të rregulluara, dhe duke i përshtatur këto llogari me klasat e zërave të “Pasqyrave të pozicionit financiar”, që aktualisht përdoren në listën e njësuar të llogarive për sektorin e energjisë elektrike.

Kjo rregullore synon të sigurojë:

- një sistem të qëndrueshëm dhe të njëjtë të mbetjes së llogarive për vlerësimin e investimeve dhe metodologjitë e miratimit të tarifave që zbatohen nga ERE;

- uniformitetin në raportimin mbi kostot, të ardhurat dhe investimet nga shoqëritë e rregulluara;

- thjeshtëzimin e përpunimit dhe analizimit të elementeve të kostos dhe të ardhurave që përdoren për përcaktimin e kërkesës për të ardhurat e kërkuara të arsyeshme të shoqërive të rregulluara gjatë procesit të aplikimit të tarifave dhe vlerësimit të investimeve;

- kjo rregullore do të shërbejë si bazë për kontrollet dhe monitorimet e llogarive të shoqërive që ushtrojnë aktivitetin në sektorin e gazit natyror, nga ana e ERE-s;

- rregullorja ofron kuadrin e nevojshëm, për:

- llogaritjen e kostove dhe të ardhurave operative;

- amortizimin; dhe

- normën e kthimit mbi bazën e rregulluar të aseteve.

- Rregullorja mbi sistemin e njësuar të llogarive për shoqëritë e rregulluara në sektorin e gazit natyror është përgatitur bazuar në:

- legjislacionin përkatës për kontabilitetin në Shqipëri; si dhe

- strukturat e llogarive në përdorim nga ERE për sektorin e energjisë elektrike.

- rregullorja dhe shtojca 1 që përmban listën e njësuar të llogarive, është përshtatur me listën e njësuar të llogarive të sektorit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin nr. 244, datë 26.11.2018, të bordit të ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e “Rregullores mbi sistemin e njësuar të llogarive për shoqëritë e rregulluara në sektorin e gazit natyror” (bashkëlidhur).

2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkolet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

RREGULLORJA

MBI SISTEMIN E NJËSUAR TË LLOGARIVE PËR SHOQËRITË E RREGULLUARA NË SEKTORIN E GAZIT NATYROR

Neni 1

Fushëveprimi i rregullores

1. Sistemi i njësuar i llogarive rregullatore përcakton llogaritë për mbajtjen e regjistrave të kontabilitetit dhe hartimin e raporteve financiare për qëllime rregullatore.

2. Sistemi i njësuar i llogarive bazohet në parimet e Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK), si dhe ligjit të kontabilitetit që zbatohet për shoqëritë që operojnë në Republikën e Shqipërisë.

3. Sistemi i njësuar i hollësishëm i llogarive i ndarë sipas aktiviteteve të rregulluara pasqyrohet në shtojcën e kësaj rregulloreje.

Neni 2

Zbatueshmëria

1. Sistemi i njësuar i llogarive të përcaktuara nga kjo rregullore është i detyrueshëm për shoqëritë të cilat Enti Rregullator i Energjisë i Shqipërisë (në vijim referuar “ERE”) i ka licencuar për kryerjen e aktivitetit në sektorin e gazit natyror dhe për të cilat ERE përcakton ose miraton tarifat dhe çmimet për shërbimin transmetim-depozitim dhe shpërndarje.

2. Struktura dhe numrat e klasave dhe llogarive të detyrueshme do të zbatohen për lloje të ndryshme të aktiviteteve të rregulluara.

3. Sistemi i njësuar i llogarive do të përbëhet nga llogaritë e detyrueshme në bazë të të cilave do të përgatiten pasqyrat financiare (pasqyrat financiare do të mbahen në përputhje me këtë sistem uniform llogarish, ligjin e kontabilitetit, SNK, rregulloret përkatëse në Shqipëri, si dhe çdo informacion që do të paraqitet për qëllime rregullatore).

4. Një shoqëri që kryen aktivitet të rregulluar, mund të zhvillojë llogari të mëtejshme analitike në bazë të nevojave të saj.

5. Në rast se shoqëria e rregulluar miraton sistemin e llogarive me një klasifikim të ndryshëm të grupeve të llogarive nga llogaritë e përcaktuara në këtë rregullore, në këtë rast, ajo duhet të ofrojë një pasqyrë krahasuese dhe specifikime të detajuara se si llogaritë përkatëse të adaptuara në një sistem të tillë llogarish, krahasohen me llogaritë e paraqitura në këtë rregullore.

Neni 3

Kuptimi i termave

1. Fjalët dhe shprehjet në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim sikurse ato të përcaktuara në:
 - a) ligjin nr. 25/2018, datë 10.5.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare në Shqipëri”;
 - b) ligjin nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit në Shqipëri”;
 - c) ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike në Shqipëri”;
 - d) rregulloret e tjera që rregullojnë kontabilitetin dhe raportimin financiar në Shqipëri; si dhe
 - e) SNRF dhe SNK.

Neni 4

Klasifikimi

Sistemi i llogarive sistemon klasat dhe zërat për çdo aktivitet të rregulluar duke përdorur parimin e llogarive treshifrore, me llogari specifike analitike dhe nënanalitike për shpërndarjen e saktë të kostove sipas llojit, vendndodhjes, efekteve dhe elementeve të tjera kryesore për të siguruar zbatimin e plotë të rregullave për ndarjen e llogarive ndërmjet aktiviteteve të ndryshme të rregulluara në sektorin e gazit natyror, si dhe aktiviteteve të parregulluara që nuk lidhen me gazin natyror, me qëllim dokumentimin dhe justifikimin e shpenzimeve në procedurën e rishikimit të tarifave.

Neni 5

Kërkesat minimale për llogaritë e ndara

1. Një shoqëri e rregulluar që mban një licencë nga ERE për të kryer aktivitete në sektorin e gazit natyror, duhet të mbajë të dhëna kontabël, për:
 - a) çdo lloj aktiviteti të rregulluar më vete; dhe
 - b) veçmas për aktivitetet jo të rregulluara.
2. Përveç kësaj, një shoqëri e rregulluar që ushtron aktivitet në fushën e gazit natyror duhet t'i mbajë të dhënat në mënyrë të tillë që të lejojë identifikimin e zërave të kostove dhe të ardhurave, si dhe shpërndarjen e tyre sipas kategorive të ndryshme të konsumatorëve dhe natyrës së konsumit.

Neni 6

Segmentet operative sipas aktivitetit të rregulluar

1. Një segment operativ përbëhet nga një pjesë e një sipërmarrjeje që merret me aktivitet që gjeneron të ardhura ose shpenzime (përfshirë të ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me transaksionet me pjesë të tjera të sipërmarrjes) rezultatet e veprimtarisë së të cilave rishikohen rregullisht nga menaxhimi i shoqërisë me qëllim marrjen e vendimeve, ndër të tjera, në lidhje me alokimin e burimeve në një segment dhe vlerësimin e performancës së tij.
2. Shoqëria e rregulluar është e detyruar të identifikojë si segment të veçantë operativ secilin nga aktivitetet e rregulluara që ajo kryen në sektorin e gazit natyror, si dhe aktivitetet e tjera që nuk lidhen me aktivitetet e gazit natyror.
3. Shoqëria e rregulluar do të bëjë ndarjen e llogarive ndërmjet llojeve të ndryshme të aktiviteteve të rregulluara që kryhen nga i njëjti person juridik në përputhje me kushtet e licencave të lëshuara dhe do të raportojë në përputhje me SNRF 8 në lidhje me segmentet operative.
4. Raportimi për një segment të aktivitetit të rregulluar duhet të përmbajë informacion financiar të veçantë, të tillë si: raporti mbi rezultatin për aktivitetin e rregulluar gjatë periudhës raportuese (pasqyra e të ardhurave dhe shpenzime).

5. Shoqëria e rregulluar duhet të paraqesë raporte financiare të audituara sipas segmenteve të shoqërisë për secilin aktivitet të rregulluar në të cilin angazhohet, duke përfshirë rishikimin e metodës së aplikuar për ndarjen e kostove të përbashkëta dhe kostove të segmenteve që përfshijnë aktivitetet e parregulluara.

Neni 7

Shërbimet ndihmëse dhe mbështetëse të shoqërisë

1. Aktivitetet për shërbimet ndihmëse dhe mbështetëse në një shoqëri të rregulluar përbëhen nga të gjitha aktivitetet që kryhen brenda shoqërisë me qëllim kryerjen e aktiviteteve të rregulluara, ose aktivitete të tjera që mund të kryhen jashtë saj dhe efektet e të cilave mund të maten financiarisht.

2. Çmimet e brendshme të produkteve dhe shërbimeve të aktiviteteve për shërbimet ndihmëse dhe mbështetëse njihen në vlerën më të ulët midis kostos dhe çmimit të tregut, gjithsesi këto do të analizohen dhe rishikon në kushtet e kostove reale të sigurimit të këtyre shërbimeve.

3. Aktivitetet për shërbimet ndihmëse dhe mbështetëse mund të përfshijnë, por pa u kufizuar, aktivitete të tilla si në vijim:

- a) studim/kërkim;
- b) zhvillim;
- c) projektim;
- d) testim dhe matje të parametrave të ndryshëm në proceset e aktivitetit bazë;
- e) transport rrugor;
- f) ushqim social;
- g) mirëmbajtja e mjeteve lëvizëse;
- h) standardizim i pajisjeve të përdorura për marrjen dhe përpunimin e të dhënave etj.

Neni 8

Reflektimi i aktiviteteve dytësore

1. Aktivitetet dytësore përbëhen nga aktivitetet e kryera nga një shoqëri e rregulluar, të cilat nuk lidhen me kryerjen e aktiviteteve të rregulluara dhe pjesa mbizotëruese e produktit apo shërbimit të të cilave realizohet ose mund të blihet prej të tretëve në treg.

2. Llogaritë në lidhje me aktivitetet dytësore për qëllimet e kësaj rregulloreje mund të paraqiten në pasqyrat financiare të një shoqërie të rregulluar në mënyrë kolektive si një segment i vetëm, që mbulon të gjitha aktivitetet dytësore.

3. Çmimet e brendshme të produkteve dhe shërbimeve që lidhen me aktivitetet dytësore duhet të reflektohen në vlerën më të ulët midis kostos dhe çmimit të tregut.

Neni 9

Të ardhurat dhe shpenzimet e segmenteve/aktiviteteve

1. Të ardhurat dhe shpenzimet e segmentit/aktivitetit, si dhe aktivet dhe detyrimet e tij, përcaktohen në shumat që i atribuohen drejtpërdrejt një segmenti/aktiviteti.

2. Alokimi i zërave në një segment/aktivitet bëhet në baza të arsyeshme dhe paraqitet në një mënyrë të kuptueshme.

3. Metoda e regjistrimit të ndryshimeve të biznesit sipas segmenteve/aktiviteteve duhet të kryhet si më poshtë:

- a) duke krijuar llogaritë analitike sipas llojit, për secilën llogari të ardhurash dhe shpenzimesh të segmentit/aktivitetit; dhe

b) alokimin/shpërndarjen e duhur të kostove të përbashkëta dhe shpenzimeve të aktiviteteve ndihmëse dhe shoqëruese në llogaritë e aktivitetit të rregulluar sipas koeficientëve të paracaktuar.

Neni 10

Ndarja e aktiveve, kapitalit dhe detyrimeve

1. Aktivet fikse do të mbahen në llogaritë e përcaktuara, të përpunuara në mënyrë analitike për secilin aktivitet të rregulluar, duke respektuar parimet e ndarjes së llogarive, në mënyrë që secili aktiv fiks të mund t'i ngarkohet drejtpërdrejt një segmenti të caktuar.

2. Pjesët e aktiveve të cilat përdoren bashkërisht nga dy ose më shumë segmente i ndahen segmenteve në përputhje me natyrën dhe aktivitetin me të cilat ato lidhen, për sa kohë që të ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me to ndahen gjithashtu në të njëjtët segmente.

3. Për aktivet të cilat nuk i shërbejnë drejtpërdrejt vetëm një aktiviteti brenda strukturës aktuale organizative të shoqërisë, mund të krijohen llogari të veçanta analitike, ose ato mund të paraqiten si zëra të paalokuar.

4. Kapitali dhe detyrimet ndahen në segmente sipas ndarjes së aktiveve me të cilat ato lidhen.

5. Kapitali dhe detyrimet të cilët nuk i shërbejnë vetëm një aktiviteti duhet të alokohen në përpjesëtim me shpërndarjen e aktiveve me të cilat ato lidhen, ose mund të paraqiten si zëra të paalokuar.

6. Aktivet e përdorura për kryerjen e aktiviteteve ndihmëse dhe shoqëruese u ngarkohen segmenteve përkatëse të këtyre aktiviteteve.

Neni 11

Parimi i kostove dhe të ardhurave të ndara

Të ardhurat dhe shpenzimet operative të kompanive duhet të regjistrohen sipas segmenteve dhe qendrave të kostos.

Neni 12

Regjistrimi i shpenzimeve

1. Shpenzimet që lidhen me aktivitetin e rregulluar ose të parregulluar do të ndahen:

a) drejtpërsëdrejti, nëpërmjet një alokimi primar (që ndodh në kohën e ndryshimit të biznesit për shoqërinë); ose

b) në mënyrë indirekte, nëpërmjet alokimit dytësor të kostove:

i. nëpërmjet huamarrjes së brendshme ose nëpërmjet:

ii. përdorimit të brendshëm (çmimet e transferimit); ose

iii. duke përdorur koeficientët e përshtatshëm të ndarjes për secilin aktivitet.

2. Shoqëria e rregulluar regjistron kostot primare:

a) në lidhje me çdo aktivitet të rregulluar;

b) në lidhje me aktivitetet dytësore;

c) në lidhje shërbimet ndihmëse dhe shoqëruese;

d) në lidhje me kostot e përbashkëta për një shoqëri; dhe

e) në lidhje me kostot e tjera të përbashkëta, të tilla si: shpenzimet e prokurimit dhe përgatitjes teknike, si dhe qendrat e kostove të përgjithshme, çështjet administrative dhe menaxhimin.

3. Shpenzimet për shërbimet ndihmëse dhe shoqëruese u ngarkohen drejtpërdrejt segmenteve të këtyre aktiviteteve.

Neni 13

Alokimi i kostos dhe përcaktimi i tarifave

1. Shoqëria e rregulluar do të alokojë koston e prokurimit, përgatitjes teknike, shitjes dhe shërbimit ndaj klientëve dhe kostot e tjera të përbashkëta për klientët individualë, duke përdorur koeficientë të paracaktuar të alokimit.

2. Koeficientët e paracaktuar të alokimit do të ndajnë shpenzimet e funksioneve të përbashkëta sipas llojit të kostove dhe duhet të shoqërohen me një shpjegim të detajuar të metodologjisë së miratuar për ndarjen në shënimet e pasqyrave financiare.

3. Shpenzimet e përgjithshme, si ato administrative dhe shpenzimet e menaxhimit mund të alokohen për aktivitete të rregulluara dhe aktivitete të tjera, duke zbatuar koeficientë specifike për ndarjen e çdo lloji kostojë për qëllim të miratimit të çmimeve dhe tarifave, sipas mënyrës dhe sipas kushteve specifike që mund të përcaktohen herë pas here nga Metodologjia e Tarifave.

4. Në kushtet kur shoqëria e rregulluar nuk ka dhënë argumente të mjaftueshme për metodologjitë e zbatuara për alokimin e kostove dhe/ose koeficientët individual të ndarjes së kostove, ERE mund të zgjedhë një metodë për alokimin e kostove sipas praktikave më të mira ndërkombëtare.

Neni 14

Detyrimi i raportimit financiar

1. Shoqëria e rregulluar do të dorëzojë rregullisht raporte financiare në ERE në përputhje me parashikimet e nenit 30, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, si dhe shtojcës 1 të kësaj rregulloreje.

2. ERE mund të përcaktojë dhe forma të tjera të ndryshme për raportim, si dhe të kërkojë dorëzimin e raporteve sipas intervaleve të ndryshme raportuese, kur është e nevojshme.

Neni 15

Çështjet që nuk rregullohen me këtë rregullore

Për të gjitha çështjet që nuk përcaktohen në këtë rregullore, do të zbatohen dispozitat e mëposhtme (në rendin e përcaktuar më poshtë):

- a) legjislacioni shqiptar për kontabilitetin;
 - b) Metodologjia e Tarifave;
 - c) çdo rregullore tjetër që ka të bëjë me mbajtjen e llogarive dhe të raportimit financiar për arsye të politikave të biznesit;
 - d) Standardet e SNRF dhe SNK;
- ose ligje të tjera, rregulla dhe rregullore të cilat do të zëvendësojnë, ndryshojnë ose përditësojnë ato që u përmendën më sipër.

Neni 16

Hyrja në fuqi

1. Kjo rregullore botohet në Fletoren Zyrtare të Shqipërisë.
2. Kjo rregullore hyn në fuqi në datën 1.1.2020.

SHTOJCA 1
SISTEMI I NJËSUAR I LLOGARIVE PËR SHOQËRITË E TRANSMETIMIT DHE
DEPOZITIMIT NË SEKTORIN E GAZIT NATYROR

Klasa 1: KAPITALI

10 KAPITALI DHE REZERVAT

101 Kapitali themeltar

1010 Kapitali vet

1011 Aksionet e kompanive me përgjegjësi të kufizuar

1012 Aksionet

1013 Kapitali shtetëror

1019 Kapitali tjetër aksionar

104 Prime të lidhura me kapitalin

105 Rezervat nga rivlerësimi

10510 Rezerva nga rivlerësimi i aktiveve fikse

10520 Rezerva nga rivlerësime të tjera

106 Rezerva të tjera

1061 Primi i emetimit

1062 Rezerva ligjore

1063 Rezerva statutore dhe të tjera

1071 Humbje të periudhës së mëparshme

107110 Humbje të periudhës së mëparshme – shërbimi i transmetimit

107120 Humbje të periudhës së mëparshme – shërbimi i depozitimit

107140 Humbje të periudhës së mëparshme – shërbime të tjera

1072 Fitimi i periudhës së mëparshme

107210 Fitimi i periudhës së mëparshme – shërbimi i transmetimit

107220 Fitimi i periudhës së mëparshme – shërbimi i depozitimit

107240 Fitimi i periudhës së mëparshme – shërbime të tjera

11 Rezervat (fitime të pashpërndara)

111 Rezerva të përgjithshme

112 Rezerva nga rivlerësimi

11210 Rezerva nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata

11220 Rezerva nga rivlerësime të tjera

113 Rezerva për investime

114 Rezerva të tjera

12 FITIME DHE HUMBJE TË USHTRIMIT

121 Fitimi/humbje i pashpërndarë nga viti aktual

12110 Fitimi/humbje nga aktivitetet e rregulluara

12120 Fitimi/humbje nga aktivitetet e parregulluara

12150 Fitimi/humbje – shërbime të tjera

13 Subvencione për investime të ngjashme (të ardhura nga prime, subvencione, donacione dhe të ngjashme)

131 Subvencione për pajisje

13110 Financimi i aktiveve afatgjata të përdorura në transmetimin e gazit natyror

131101 Financimi nga buxheti për aktive afatgjata të përdorura në transmetimin e gazit natyror

131102 Financimi nga burime të tjera për aktive afatgjata të përdorura në transmetimin e gazit natyror

1320 Financimi i aktiveve fikse të përdorura në aktivitetet e rregulluara

1390 Financimi i aktiveve fikse të përdorura në aktivitetet e parregulluara
 137 Financimi i investimeve të tjera
 13710 Financimi i aktiviteteve operative të lidhura me transmetimin e gazit natyror
 137101 Financimi nga buxheti i aktiviteteve operative të lidhura me transmetimin e gazit natyror
 137102 Financimi nga burime të tjera i aktiviteteve operative të lidhura me transmetimin e gazit natyror
 natyror
 13720 Financimi i aktiviteteve operative të tjera të rregulluara
 13730 Financimi i aktiviteteve operative të tjera të parregulluara
 138 Aktive të qëndrueshme të marra pa pagesë (grante)
 15 Shuma të parashikuara për rreziqe e shpenzime
 151 Shuma të parashikuara për rreziqe
 1511 Për detyrime në konflikt
 1514 Për garancitë e klientëve
 1515 Për humbje nga këmbimi
 1518 Për rreziqe të tjera
 153 Shuma të parashikuara për pensione dhe detyrime të ngjashme
 157 Shuma të parashikuara për shpenzime që shpërndahen në disa ushtrime
 1572 Për riparime të mëdha
 158 Shuma të parashikuara për shpenzime të tjera
 16 HUA DHE DETYRIME TË NGJASHME
 161 Huat e marra për periudha afatshkurtra
 1611 Hua në obligacione
 16111 Shuma e huas (principali)
 16118 Interesa të maturuar
 163 Hua nga bankat dhe institucionet e tjera të kreditit
 1631 Shuma e huas (principali)
 1638 Interesa të maturuar
 165 Depozita dhe dorëzani të marra
 167 Detyrime të lidhura me pjesëmarrjet
 1671 Shuma e detyrimit
 1678 Interesa të maturuar
 168 Të tjera hua dhe detyrime
 1681 Shuma e huas ose detyrimit
 1688 Interesa të maturuar
 Klasa 2: AKTIVE TË QËNDRUESHME
 20 Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara
 201 Shpenzime të nisjes dhe zgjerimit
 2011 Shpenzime të nisjes dhe zgjerimit për transmetim
 2013 Shpenzime të nisjes dhe zgjerimit për dispeçerim
 2014 Shpenzime të nisjes dhe zgjerimit për qëllime të përgjithshme dhe administrimi
 203 Shpenzime të kërkimeve të aplikuara dhe zgjerimeve
 2031 Shpenzime të kërkimeve të aplikuara dhe zgjerimeve për transmetim të gazit natyror
 2033 Shpenzime të kërkimeve të aplikuara dhe zgjerimeve për dispeçerim
 2034 Shpenzime të kërkimeve të aplikuara dhe zgjerimeve për qëllime të përgjithshme dhe administrimi
 205 Koncesione dhe të drejta të ngjashme, patenta, licenca, marka dhe vlera të tjera të ngjashme
 2051 Patenta, licencat, marka tregtare të përdorura për transmetim të gazit natyror
 2053 Patenta, licencat, marka tregtare të përdorura në dispeçerim

2054 Patenta, licencat, marka tregtare të përdorura për qëllime të përgjithshme dhe administrative
 206 Software
 207 Fonde tregtare
 208 Të tjera aktive të qëndrueshme të patrupëzuara
 2081 Të tjera aktive të qëndrueshme të patrupëzuara të përdorura në transmetimin e gazit natyror
 2083 Të tjera aktive të qëndrueshme të patrupëzuara në dispeçerim
 2084 Të tjera aktive të qëndrueshme të patrupëzuara të përgjithshme dhe administrim
 209 Të tjera aktive të qëndrueshme të patrupëzuara për aktivitete të parregulluara
 21 Aktive të qëndrueshme të trupëzuara
 211 Toka
 21110 Toka (terrene) pa ndërtime në përdorim për transmetimin e gazit natyror
 21120 Toka për ndërtesat dhe pajisjet e sistemit të transmetimit
 21140 Toka me ndërtime
 211401 Toka për ndërtesat e përgjithshme dhe administrative dhe facilitete të tjera për aktivitetet
 e rregulluara
 211402 Toka për ndërtesat dhe facilitet për aktivitetet e parregulluara
 21150 Sistemime dhe rregullime të tokave
 212 Ndërtimet
 21210 Ndërtesa
 212101 Ndërtesa për transmetimin e gazit natyror
 21250 Ndërtime dhe instalime të përgjithshme
 212501 Ndërtime dhe instalime të përgjithshme për transmetimin e gazit natyror
 212502 Ndërtesa dhe struktura për aktivitetet e parregulluara
 212503 Ndërtesat e përgjithshme dhe administrative
 21260 Vepra të infrastrukturës
 21261 Për transmetimin e gazit natyror
 21270 Rregullime të përgjithshme
 213 Instalime teknike, makineri, pajisje, instrumente dhe vegla pune
 21310 Instalime teknike specifike
 213101 Linjat e përdorura për transmetimin e gazit natyror
 213106 Të tjera linja
 21320 Instalime teknike komplekse
 213201 Instalime teknike të përdorura për transmetimin e gazit natyror
 213206 Të tjera
 21330 Makineri e pajisje
 213301 Makineri e pajisje për transmetimin e gazit natyror
 213306 Të tjera
 21340 Makineri e pajisje pune – pajisjet e matjes
 213401 Pajisjet e matjes për shpërndarjen/transmetimin/depozitim e gazit natyror
 213406 Matës të tjerë dhe pajisje matëse
 21350 Instrumente dhe vegla
 213501 Instrumente të përdorura në transmetim
 213502 Instrumente të përdorura në shitje
 213503 Instrumente të përdorura në dispeçerim
 213504 Instrumente për përdorim administrativ dhe të përgjithshëm
 213505 Instrumente të përdorur në aktivitete të parregulluara
 21360 Sistemet kompjuterike
 213601 Kompjuterët e përdorur në sistemin e transmetimit të gazit natyror

213604 Kompjuterë të përdorur në dispeçerim
 213605 Kompjuterët e përdorur për qëllime të përgjithshme dhe administrative
 21370 Pajisje dhe impiante të tjera
 213701 Të përdorura në operim
 213702 Të përdorura në mirëmbajtje
 21380 Pajisje dhe impiante për aktivitete të parregulluara
 215 Mjete Transporti
 21510 Mjete në shërbim të aktivitetit të transmetimit të gazit natyror
 215101 Makina
 215102 Kamionë
 215103 Makina të specializuara
 215104 Të tjera
 21540 Mjete të përdorura në dispeçerim
 21550 Mjete për përdorim administrativ dhe të përgjithshëm
 215501 Makinat
 215502 Të tjera
 21590 Mjete të përdorura në aktivitete të parregulluara
 216 Ambalazh i paluajtshëm dhe i rikthyeshëm
 218 Të tjera aktive të qëndrueshme të trupëzuara
 2181 Mobilie dhe orendi
 2182 Pajisje zyrash dhe informatike
 2188 Të tjera
 23 AKTIVE TË QËNDRUESHME NË PROCES, PARAPAGIME DHE PAGESA PJESORE
 231 Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara në proces
 23110 Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara në proces – aktivitete të rregulluara
 23190 Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara në proces – aktivitete të parregulluara
 232 Aktive të qëndrueshme të trupëzuara në proces
 23210 Aktive të qëndrueshme të trupëzuara në proces – aktivitete të rregulluara
 23290 Aktive të qëndrueshme të trupëzuara në proces të tjera – aktivitetet e parregulluara
 233 Parapagime dhe pagesa pjesore për aktive të qëndrueshme të patrupëzuara
 234 Parapagime dhe pagesa pjesore për aktive të qëndrueshme të trupëzuara
 26 AKTIVE TË QËNDRUESHME FINANCIARE
 261 Tituj të pjesëmarrjes
 262 Tituj të portofolit
 263 Tituj të tjerë
 264 Aksione ose pjesë të vetat
 265 Depozita e dorëzani të tjera
 266 Kredidhënie
 2661 Shuma kryesore
 266 Interesa të maturuara për t'u marrë
 267 Kërkesa të lidhura me pjesëmarrjet
 2671 Shuma kryesore
 2678 Interesa të maturuara për t'u marrë
 269 Derdhje për t'u kryer për titujt e padorëzuar
 2691 Për titujt e pjesëmarrjes
 2692 Për titujt e portofolit
 2695 Për titujt e tjerë
 28 AMORTIZIME TË AKTIVEVE TË QËNDRUESHME

280 Amortizime të aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara
 2801 Për shpenzimet e nisjes
 280101 Për shpenzimet e nisjes dhe zgjerimit për aktivitetin
 280102 Për shpenzimet e nisjes dhe zgjerimit për dispeçerimin
 280103 Për shpenzimet e nisjes dhe zgjerimit të përgjithshme dhe administrative
 28020 Për shpenzimet e kërkimeve dhe zhvillimeve
 280201 Për shpenzimet e kërkimeve dhe zhvillimeve për aktivitetin
 280202 Për shpenzimet e kërkimeve dhe zhvillimeve për dispeçerimin
 280203 Për shpenzimet e kërkimeve dhe zhvillimeve të përgjithshme dhe administrative
 28050 Për koncesione dhe të drejta të ngjashme, patenta licenca, marka, të drejta dhe vlera të ngjashme
 280501 Për patentat, licencat, marka tregtare të përdorura për aktivitetin
 280502 Për patentat, licencat, marka tregtare të përdorura në dispeçerim
 280503 Për patentat, licencat, marka tregtare të përdorura për qëllime të përgjithshme dhe administrative
 28070 Për fondet tregtare
 28080 Për të tjera aktive të qëndrueshme të patrupëzuara
 280801 Për të tjera aktive të qëndrueshme të patrupëzuara për aktivitetin
 280802 Për të tjera aktive të qëndrueshme të patrupëzuara në dispeçerim
 280803 Për të tjera aktive të qëndrueshme të patrupëzuara të përgjithshme dhe administrative
 281 Amortizime të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuar
 28110 Për terrenet e amortizueshme, sistemimet dhe rregullimet Nëndarjet sipas aktiviteteve dhe të tjera (llogaritë analitike do të jenë në përputhje me grupin e llogarive 211)
 28120 Për ndërtimet
 Nëndarjet sipas aktiviteteve dhe të tjera (llogaritë analitike do të jenë në përputhje me grupin e llogarive 212)
 28130 Për instalimet teknike, makineritë pajisjet, instrumente dhe veglat e punës (llogaritë analitike do të jenë në përputhje me grupin e llogarive 213)
 281301 Kostoja e amortizimit në lidhje me tubacionet e transmetimit të gazit natyror
 281303 Kostoja e amortizimit në lidhje me cisternat e depozitimit të gazit natyror në tokë
 281304 Kostoja e amortizimit në lidhje me cisternat e depozitimit të gazit natyror në det
 281307 Kostoja e amortizimit në lidhje me pajisjet e tjera për aktivitetin e gazit natyror (specifikoni)
 281310 Kostot e amortizimit të aktiveve jomateriale (për ato me amortizim të llogaritur)
 28150 Për mjetet e transportit (nëndarjet më poshtë do të jenë në përputhje me grupin e llogarive 215)
 281501 Amortizimi I
 281502 Amortizimi I
 281503 Amortizimi I
 281504 Amortizimi I
 28160 Për ambalazhet e paluajtshme e të kthyeshme
 28180 Për të tjera aktive të qëndrueshme të trupëzuara
 29 SHUMA TË PARASHIKUARA PËR ZHVLERËSIME TË AKTIVEVE TË QËNDRUESHME
 290 Për aktivet e qëndrueshme të patrupëzuara
 29050 Për koncensione, patenta, licenca, marka
 29080 Për të tjera aktive të qëndrueshme të patrupëzuara
 291 Për aktivet e qëndrueshme të trupëzuara

29110 Për terrenet e paamortizueshme
29120 Për ndërtimet
29130 Për instalimet, makineritë, pajisjet
29150 Për mjetet e transportit
29160 Për ambalazhet e paluajtshme dhe të kthyeshme
29180 Për të tjera aktive të qëndrueshme të trupëzuara
293 Për aktivet e qëndrueshme në proces
29310 Për aktivet e qëndrueshme në proces të patrupëzuara
29320 Për aktivet e qëndrueshme në proces të trupëzuara
296 Për aktivet e qëndrueshme financiare
29610 Për titujt e pjesëmarrjes
29660 Për kredidhëniet
29670 Për kërkesat për t'u arkëtuar

Klasa 3: INVENTARËT

31 Materiale

310 Materiale magazinimi

3100 Llogaritja e furnizimeve të materialeve, pjesëve të këmbimit, mjeteve dhe inventarëve të tjerë

3101 Materiali

3102 Pjesë këmbimi

3103 Mjetet dhe inventarët

3109 Korrigjimi i vlerës së inventarit të materialeve

32 Objekte inventari

33 Produkte (punime, shërbime) në proces

330 Prodhim i papërfunduar

331 Shërbime të papërfunduara

34 Produkte

340 Produkte të gatshme

35 Mallra

350 Blerja e mallrave

350001 Gaz natyror në cisterna depozitimi në tokë

350002 Gaz natyror në cisterna depozitimi në det

350003 Gaz natyror në mjedise të tjera depozitimi (specifikoni)

351 Mallra

352 Mallra në tregtinë me shumicë

353 Mallra në depozitim të mbajtura me persona të tjerë juridikë

353001 Gaz natyror në cisterna depozitimi në tokë

353002 Gaz natyror në cisterna depozitimi në det

353003 Gaz natyror në mjedise të tjera depozitimi (specifikoni)

354 Gaz natyror në ruajtje mbajtur me persona të tjerë juridikë

35400 Gaz natyror në cisterna depozitimi në tokë mbajtur me persona të tjerë juridikë

354002 Gaz natyror në cisterna depozitimi në det mbajtur me persona të tjerë juridikë

354003 Gaz natyror në mjedise të tjera depozitimi (specifiko) mbajtur me persona të tjerë juridikë

37 Gjendje të pambërritura ose pranë të tretëve

38 Diferenca nga çmimet e magazinimit

39 Shuma të parashikuara për zhvlerësime

Materiale produkte dhe mallrat e përdorur nga aktivitete të parregulluara

Klasa 4

40 Furnitorë dhe llogari të lidhura
401 Llogari të pagueshme
40110 Llogari të pagueshme – aktivitete të rregulluara
40120 Llogari të pagueshme – aktivitete të parregulluara
402 Llogari të parapaguara (llogari të arkëtueshme nga furnitori)
40210 Llogari të pagueshme ndaj furnitorëve – aktivitete të rregulluara
40220 Llogari të pagueshme ndaj furnitorëve – aktivitete të parregulluara
403 Blerje me kredi nga furnitorët
404 Furnitorë me kushte speciale
405 Të tjera
41 LLOGARI TË ARKËTUESHME NGA KLIENTËT DHE PALËT E LIDHURA
411 Llogaritë e arkëtueshme nga klientët
4111 Klientë- sipas grupeve
41110 Konsumatorë – subjektet ligjore prind dhe personat juridikë të varur
41111 Blerës – persona të tjerë juridikë të lidhur
41112 Konsumatorë brenda vendit
411120 Konsumatorët e shërbimeve të transmetimit të gazit natyror
411122 Konsumatorët e shërbimeve të depozitimit të gazit natyror
411124 Konsumatorët e shërbimeve të tjera të gazit natyror
41113 Konsumatorët jashtë vendit
412 Llogari të parapaguara nga klientët (llogari të pagueshme të klientëve)
41210 Klient – transmetimi i energjisë elektrike
41290 Klient – aktivitete të parregulluara
413 Kredi tregtare për konsumatorin
414 Llogari të arkëtueshme nga shitjet te konsumatorët me kushte speciale
415 Arkëtime në monedha të huaja për kreditë tregtare
416 Llogari të arkëtueshme dhe llogari të pagueshme nga shitjet ndaj palëve të lidhura
42 DETYRIME NDAJ PUNONJËSVE
421 Llogari të pagueshme ndaj punonjësve
422 Llogari të arkëtueshme nga punonjësit të lidhur me angazhime të veçanta
43 Sigurime shoqërore dhe llogari të lidhura
44 Shteti llogari të lidhura
45 Grupe dhe ortake
451 Llogari të grupit
46 Debitorë dhe kreditorë të ndryshëm
462 Kërkesa për t'u arkëtuar nga shitja e aktiveve të qëndrueshme
464 Kërkesa për t'u arkëtuar nga disbalancat
465 Detyrim për t'u paguar për disbalancat
466 Debitorë të tjerë, kreditorë të tjerë
47 Llogari të përkohshme ose në pritje
48 Llogari rregulluese
49 Shuma të parashikuara për zhvlerësim
491 Shuma të parashikuara për klientët – sipas grupeve
495 Shuma të parashikuara për grupin
496 Shuma të parashikuara për debitorë të ndryshëm
Klasa 5: LLOGARITË FINANCIARE
50 LETRAT ME VLERË TË VENDOSJES
502 Aksione të vetat

506 Obligacione
 508 Tituj pronësie
 51 BANKA DHE INSTITUCIONE TË NGJASHME
 511 Vlera për t'u arkëtuar/paguar
 5121 Banka në lekë
 5124 Banka në valutë
 5125 Letra krediti në lekë
 5126 Letra krediti në monedhë të huaj
 5127 Depozitat
 5128 Çeqe për t'u paguar
 5129 Vlera të tjera
 52AR KA DHE VLERA TË TJERA
 5211 Arka në lekë
 5224 Arka në monedhë të huaj
 524 Të tjera
 54 AKREDITIVA DHE PARADHËNIE (HUA DHE LETRA ME VLERË TË BORXHIT DERI NË TRE MUAJ)
 58 XHIRIME TË BRENDSHME
 59 SHUMA TË PARASHIKUARA PËR ZHVLERËSIM (ZHVLERËSIMI I AKTIVEVE FINANCIARE)
 Klasa 6: LLOGARITË E SHPENZIMEVE
 60 Blerje dhe ndryshimi i gjendjeve/shpenzime sipas natyrës ekonomike
 601 Blerje materialesh të para
 60110 Materiale të përdorura në operacione – aktivitete të rregulluara
 601101 Materialet të përdorura në transmetimin e gazit natyror
 601104 Materiale të përdorura në dispeçerim
 601105 Materiale të përdorura për lidhjet e reja
 601106 Materialet të përdorura për investime kapitale
 60120 Materialet e përdorura për mirëmbajtjen e brendshme lidhur me operacionet
 601201 Materialet e përdorura në pajisjet matëse
 601202 Materialet e përdorura në faturime dhe arkëtim
 601203 Materialet e përdorura në shërbimin ndaj klientit
 601204 Materialet e përdorura në marketing dhe reklamë
 601205 Materialet e përdorura për mirëmbajtje
 601206 Materiale të tjera të përdorur në marketing
 60140 Materialet e përdorura për klientët e kualifikuar etj.
 601401 Materialet e përdorura në pajisjet matëse
 60150 Materiale të përdorura për qëllime të përgjithshme dhe administrative
 601501 Pajisje zyre
 601502 Karburant dhe materiale të tjera për transportim për qëllime administrative dhe të përgjithshme
 601503 Materiale për mirëmbajtje të lidhur me aktivitete të përgjithshme dhe administrative
 601504 Materiale të tjera të përdorura në aktivitete të përgjithshme dhe administrative
 60160 Materiale të përdorura në kërkim-zhvillim
 60190 Materiale të përdorura në aktivitete të parregulluara
 602 Blerje materialesh të tjera të stokueshme
 60210 Karburant i përdorur në operacione sipas nënndarjeve në llogarinë e materialeve
 60220 Karburant i përdorur në mirëmbajtje

60230 Karburant i përdorur në shërbimin ndaj klientëve të kualifikuar etj.
60240 Karburant për qëllime administrative dhe të përgjithshme
60290 Karburant i përdorur në aktivitet e parregulluara
603 Ndryshimi i gjendjeve të materialeve dhe mallrave të blera
6031 Ndryshimi i gjendjeve të materialeve të para
6032 Ndryshimi i gjendjeve të materialeve të tjera
6035 Ndryshimi i gjendjeve të mallrave
604 Blerje energji, ujë
605 Blerje mallra
606 Blerje të pastokueshme, material, furnitura
6061 Blerje gazi për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit
607 Nëntrajtime që përfshihen direkt në punimet ose produktet e fabrikuara
608 Të tjera
6084 Shërbimet ndihmese
61 PUNIME E SHËRBIME NGA TË TRETËT
611 Nëntrajtime të përgjithshme
61110 Aktivitete të rregulluara
611101 Nëntrajtime në transmetimin e gazit natyror (e detajuar për nivel kapaciteti)
611104 Nëntrajtime në sistemin e matjes
611105 Materialet e përdorura në lidhjet e reja
611106 Materialet e përdorura për investimet kapitale
613 Qira
6131 Për ambientet e shërbimit të transmetimit/depozitimit
6133 Për ambientet administrative dhe të përgjithshme
